

Transporti Hekurudhor

Në kuadër të reformimit të sistemit të transportit hekurudhor nga buxheti i shtetit janë akorduan 160 milion lekë për mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera të rastit. Mirëmbajtja konsiston në ato pika të domosdoshme që bëjnë të mundur mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor.

1. Blerje traversa hekurudhore,

Rezultatet e kontrollit periodik të kryer në linjën hekurudhore evidentojnë në vazhdimësi domosdoshmërinë e ndërrimit të traversave të drurit të kalbura në linjë me traversa druri të reja, si dhe atyre speciale në ndërrueset hekurudhore, në hyrje dhe në dalje të stacioneve.

Blerja e traversave të drurit është i vetmi investim në linjën hekurudhore që lidhet me ekzistencën e transportit hekurudhor, pasi në kushtet teknike që paraqitet linja hekurudhore është i vetmi proces pune i mirëmbajtjes sistematike që mund të bëhet në hekurudhë.

2. Blerje aksesore e pajisje hekurudhore,

Domosdoshmëria për të blerë këta aksesore është e lidhur me kërkesën imediate që kanë ato për tu vendosur në linjën hekurudhore.

Përkatësisht u blenë në sasi të ndryshme, pllaka lidhëse S-49, pllaka shtruese për shina S-49, zhabica komplet për pllakat shtruese S-49, pllaka metalike te kuqe tip NABLA për traversa dy bllokëshe, tiranda linje, gozhdë hekurudhore, etj.

Blerja e këtyre elementeve është kërkesë nga njësit e mirëmbajtjes, si pasojë e kalbjes së traversave të drurit, si dhe nga vjedhja e tyre nga elementë keqbërës duke dobësuar sigurinë e linjës hekurudhore. Blerja e pllakave metalike është e domosdoshme për arsye të vjedhjes masive të tyre në linja.

3. Blerje balast hekurudhor

Do të bëhet plotësim i linjës hekurudhore me balast në zonën ku do të vendosen traversat e reja.

Me këtë investim do të mirëmbahen rreth 3 km linjë. Nevojat për këtë zë janë shumë herë më të mëdha, pasi rrjeti hekurudhor është i amortizuar.

4. Riaftësim i trasesë hekurudhore

Riaftësimi i linjave konsiston në kthimin në parametra teknike optimale të segmenteve hekurudhore, ku për shkak se materiali që gjendet në trupin e trasesë ka humbur aftësinë dhe stabilitetin për ti rezistuar forcave vertikale dinamike që krijohen nga lëvizja e mjeteve hekurudhore.

5. Punime nga vete hekurudha per transport materiale, vendosje traversash dhe pastrim kanalesh anesore

Si pasojë e amortizimit ndër vite të veprave të artit, tombino, këmbë urash, mure mbajtës, si dhe nevoja për të siguruar linjën hekurudhore nga rrëshqitjet e dherave në zonat në rrëshqitje, është menduar që në këtë plan të parashikohet të ndërhyhet në mirëmbajtjen e atyre ekzistuese dhe ndërtimin e pritave, mureve mbajtës, paneleve ne rrjedhat e lumenjve. Por për fat të keq ky fond u shkurtua gjatë vitit.

6. Rritja e gatishmërisë së mjeteve lëvizëse,

Me këtë investim arrihet të mbahet në gjëndje pune lokomotivat dhe vagonët pasi

dihet që lokomotivat tona kanë një moshë mesatare mbi 35 vjet. Rezultati që ne arrijmë me këtë investim është rritja e koeficientit të gatishmërisë teknike me rreth 0.1% në vit.

Emertimi i projektit te investimit	Buxheti 2017 ne leke	Plani I ndryshuar	Realizimi në fund të vitit 2017 ne leke
PROGRAMI TRANSPORTI HEKURUDHOR	360,000,000	360,000,000	
Punime per rivenien ne pune te linjes hekurudhore Librazhd Perrenjas (vazhdim I investimit te vitit 2016)	4,700,000	4,700,000	4,699
Blerje aksesore e pajisje hekurudhore	7,000,000	7,000,000	
Rikonstruksion linje Librazhd Prrenjas,	0	14,000,000	
Blerje traversa druri te reja normale dhe speciale te reja	0	31,400,000	
Blerje traversa betoni te reja te kompjetuara me aksesore te mberthyer	0	31,400,000	
Blerje cakull per ballast hekurudhor + ngarkim me vagon hekurudhor	5,000,000	5,000,000	
Riaftesim linje hekurudhore Shkozet - Rrogozhine	12,000,000	12,000,000	
Punime nga vete hekurudha per transport materiale, vendosje traversash dhe pastrim kanalesh anesore	7,000,000	7,000,000	2,621
Spostim I linjes ne km 70+00- 71+500 dhe riaftesim linje me km 133+400-133+900	11,000,000	11,000,000	
Blerje pjese kembimi per lokomotiva dhe vagona	0	16,000,000	

Rinovim agregat per lokomotiva	0	11,680,000	7,416
Riparim i reparteve te NJ.Sh.M.L	8,820,000	8,820,000	
TVSH per zbatimin projektit te linjes Tirane - Durres, per ndertimin e linjes se re Tirane-Rinas	200,000,000	200,000,000	